Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 18 qershor 2010

Lënda nr. 17/08

Gani EMINI

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 18 qershor 2010,
Në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
z. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga

z. Rajesh TALWAR, zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në përputhje me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas diskutimeve, nxori konstatimet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 12 qershor 2008 dhe është regjistruar më 17 qershor 2008.

2. Më 19 shtator 2008, Paneli shpalli ankesën si të papranueshme, për aq sa ankuesi pohonte se të drejtat e tij materiale janë shkelur, se ai ka qenë viktimë e diskriminimit dhe se e drejta e tij në gjykim të drejtë është shkelur. Paneli vendosi të shtyjë shqyrtimin e ankesës lidhur me vonesën e paarsyeshme të procedurës gjyqësore.

3. Përmes letrës së datës 19 nëntor 2008, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) është informuar për vendimin.

4. Më 4 mars 2009, PSSP-ja dha komentet e tij për rastin. Në mes të tjerash, ai ftoi Panelin të kërkojë informata nga gjykata kompetente lidhur me kohëzgjatjen e procedurave.

5. Më 17 prill 2009, Paneli miratoi vendimin e pranueshmërisë për lëndën në fjalë, duke shpallur të pranueshme ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurave.

6. Pas ftesës së PSSP-së, Paneli iu drejtua Gjykatës së Qarkut. Kryetari i kësaj Gjykate më 13 tetor 2009 dërgoi një shpjegim lidhur me kohëzgjatjen e procedurave.

7. Paneli ia përcolli këtë letër PSSP-së më 11 janar 2010, dhe ftoi atë që të jep komente për bazueshmërinë e ankesës. Më 25 janar 2010, PSSP-ja parashtroi komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmëri.

II. FAKTET

8. Ankuesi ka punuar në Entin e punësimit të RSF të Jugosllavisë, gjegjësisht në Qendrën regjionale të punësimit në Gjakovë që nga viti 1965. Pas luftës në vitin 1999, ai së bashku me punëtorët e tjerë u lajmërua në vendin e punës dhe vazhdoi të punojë. Në atë kohë duket se të punësuarit paguheshin nga komuna e Gjakovës. Sipas fjalëve të ankuesit, më 28 shkurt 2000 përmes një njoftimi me gojë atij iu komunikua lajmi se ishte pushuar nga puna. Ai në fakt ka vazhduar të punojë deri më 1 maj të vitit 2000.

9. Pas tentimeve të kota për të gjetur zgjidhje përmes organeve administrative, ankuesi ngriti padi kundër Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, gjegjësisht Departamentit të punës dhe të punësimit në Gjakovë (më tutje në tekst Departamenti), para Gjykatës komunale të Gjakovës (më tutje në tekst Gjykata komunale). Padia është regjistruar nga Gjykata më 17 prill 2003. Paditësi argumentonte se punësimi i tij asnjëherë nuk është përfunduar përmes vendimit me shkrim, kështu, ai vazhdonte të jetë i punësuar i Departamentit. Ai kërkoi nga Gjykata të shpall se ai ende është i punësuar i Departamentit dhe të urdhërojë këtë të fundit që ta kthej në vendin e punës. Përmes vendimit të datës 21 janar 2004, Gjykata komunale e hodhi poshtë padinë. Gjykata konstatoi se Departamenti nuk ishte trashëgimtar i organit, për të cilin paditësi ka punuar, kështu që paditësi nuk ishte i punësuar i Departamentit, por në fakt ishte një person i papunë.

10. Ankuesi parashtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e qarkut në Pejë (më tutje në tekst Gjykata e qarkut). Dosja e lëndës është pranuar nga Gjykata komunale më 21 prill 2004. Përmes vendimit të datës 10 janar 2007, Gjykata e qarkut e hodhi ankesën poshtë. Kjo Gjykatë e konfirmoi arsyetimin e Gjykatës komunale dhe shtoi se Departamenti kishte shpallur publikisht vendet e lira të punës dhe se një numër i ish-punëtorëve të Entit të punësimit kishte konkurruar për këto pozita dhe është përzgjedhur, por se ankuesi nuk kishte konkurruar për asnjërën prej pozitave.

11. Në një datë që nuk është cekur, ankuesi parashtroi kërkesë për rishikim të këtij vendimi. Më 15 maj 2008, kjo kërkesë është refuzuar nga Gjykata Supreme. Në bazë të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët kishin vlerësuar faktet dhe zbatuar ligjin në mënyrë të drejtë.

III. ANKESA

12. Për aq sa ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesi në thelb pohon se procedura për këtë lëndë nuk është përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, gjë që paraq et shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj).

IV. LIGJI

13. Ankuesi në thelb pohon se kohëzgjatja e procedurës në rastin e tij ka qenë tepër e madhe, gjë që paraqet shkelje të së drejtës së tij për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore, ashtu siç garantohet përmes nenit 6 § 1 të KEDNj-së.

14. Neni 6 § 1 i KEDNj-së parasheh në pjesën relevante:

> "Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të tij qytetare ..., çdokush ka të drejtë në gjykim të drejtë nga gjykata brenda një kohe të arsyeshme ..."

A. Argumentet e palëve

Parashtresa e ankuesit

15. Ankuesi kufizohet në argumentimin se është shkelur e drejta e tij për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

Parashtresat e UNMIK-ut

16. Në komentet e tij të para për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja konfirmon faktin se në bazë të lëndës, ligji i Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) parasheh që kontestet e punësimit nga natyra e tyre kërkojnë marrjen e shpejtë të vendimeve. Gjykata veçanërisht ka konsideruar kështu në lëndën *Frydlender* (ECtHR [Dhoma kryesore], *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, vendimi i datës 27 qershor 2000, § 43, *GjEDNj*, 2000-V). Megjithatë, PSSP-ja thekson se mund të bëhen dallime të rëndësishme mes fakteve në rastin *Frydlender* dhe të atyre të rastit në fjalë. Në rastin *Frydlender* procedura gjyqësore zgjati pothuajse nëntë vite e tetë muaj, ndërsa në rastin e ankuesit procedura zgjati vetëm pak më shkurt se pesë vite. Për më tepër, në rastin *Frydlender* aplikuesi kishte qasje në vetëm dy instanca lidhur me shkarkimin e tij nga puna, ndërsa ankuesi në këtë rast kishte qasje në tri instanca. Po kështu, në lëndën *Frydlender* rasati i aplikuesit është shqyrtuar nga gjykatat administrative të specializuara në çështje administrative, ndërsa gjykatat para të cilave paditësi ngriti padinë e tij ishin gjykata të rregullta.

17. PSSP-ja pranon se në rastin e ankuesit kohëzgjatja e procedurave para Gjykatës së qarkut mund të dukjet e paarsyeshme, por arsyeshmëria duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit. PSSP-ja në veçanti i referohet faktit se në kohën kur gjykatat trajtonin rastin e ankuesit, i tërë sistemi i gjykatave në Kosovë po funksiononte në një gjendje të pasluftës. Asokohe ky sistem ishte në proces të rindërtimit, gjë e cila rezultoi me një numër lëndësh të pazgjidhura dhe ua pamundësojë gjykatave që të punojnë më shpejt në lëndën e ankuesit.

18. PSSP-ja në fund argumenton se madje edhe në rrethana normale, koha e shfrytëzuar nga gjykatat në marrjen e vendimit për ankuesin përmes tri instancave nuk mund të konsiderohet si e tejzgjatur. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e procedurës duket të jetë plotësisht e arsyeshme.

19. Në komentet e tij të dyta lidhur me bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja i referohet shpjegimit të dhënë nga Gjykata e qarkut. Në bazë të atij shpjegimi, në kohën relevante, gjegjësisht prej vitit 2004 deri më 2008, në Gjykatën e qarkut kanë punuar vetëm dy gjyqtarë që kishin për detyrë të merren me numrin e madh të lëndëve civile, dhe ka qenë e nevojshme të angazhohet kryetari i Gjykatës për të themeluar kolexhin e tre gjyqtarëve. Rrjedhimisht, çfarëdo vonese e lëndës në fjalë dhe e lëndëve të tjera civile në Gjykatën e qarkut, mund t'i atribuohet vetëm faktit se gjyqtarët ishin të tejngarkuar me numër të madh të lëndëve.

20. PSSP-ja argumenton se ky shpjegim vërteton deklaratat e tij të mëparshme që i tërë sistemi i gjykatave (administratës) në Kosovë ka pasur pasoja të mëdha nga gjendja e pasluftës dhe se veçanërisht gjatë asaj kohe ka pasur vështirësi të trajtojë një numër të madh lëndësh të pazgjidhura. Neni 6 i KEDNj-së parasheh organizimin e administrimit të drejtësisë në atë mënyrë që gjykatat e ndryshme të mund të plotësojnë dispozitat e këtij neni. Duket se gjykatat e përfshira në këtë rast kanë bërë të tërën që ishte e mundur për t'iu ikur vonesave të panevojshme në procedura gjyqësore. Paditësi kishte filluar procedura në sistemin e gjykatave të Kosovës në prill të vitit 2003. Këto procedura kanë zgjatur pesë vite dhe kanë kaluar tri instanca. Duke marrë parasysh gjendjen e pasluftës në Kosovë që nga viti 1999 dhe gjendjen e përgjithshme të sistemit gjyqësor të Kosovës, një periudhë e tillë kohore për procedurat që kanë kaluar nëpër tri instanca është plotësisht e arsyetueshme dhe e duhur.

B. Vlerësimi i Panelit

1. Parimet e përgjithshme

21. Paneli rikujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kritereve si në vijim: ndërlikueshmërisë së rastit, sjelljes së paditësit dhe të autoriteteve relevante, dhe cili ka qenë interesi i paditësit në këtë kontest (shih, në mesin e shumë autoriteteve të tjera, vendimin në lëndën *Frydlender*, të cekur më lartë, § 43).

22. Po kështu, Paneli rikujton se KEDNj-ja parasheh përgjegjësinë që shtetet të organizojnë sistemin e tyre ligjor për t'ua mundësuar gjykatave t'i plotësojnë dispozitat e nenit 6 § 1, duke përfshirë edhe ato lidhur me gjykimin brenda një "periudhe të arsyeshme kohore". Derisa numri i përkohshëm i lëndëve të pazgjidhura në gjykata nuk nënkupton përgjegjësi

të autoriteteve nëse ndërmarrin veprime të duhura korrigjuese me shpejtësi të paraparë, një tejngarkesë kronike nuk mund të arsyetojë një tejzgjatje të procedurave (shih GjEDNj, *Pammel kundër Gjermanisë dhe Probstmeier kundër Gjermanisë*, vendimi i datës 1 korrik 1997, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1997-IV, p. 1112, § 69 viz. p. 1138, § 64).

2. Zbatimi i parimeve të përgjithshme për lëndën në fjalë

a. Periudha që duhet të merret parasysh

23. Padia e paditësit është regjistruar nga Gjykata komunale në Gjakovë më 17 prill 2003. Kjo datë paraqet hapjen e procedurave. Mirëpo, periudha që duhet të merret parasysh fillon nga data e juridiksionit kohor të Panelit që është 23 prill 2005. Në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohës së kaluar pas datës 23 prill 2005, Paneli megjithatë do të merr parasysh gjendjen e procedurës në atë moment (GjEDNj, *Foti dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 1982, *Publikimet e Gjykatës*, Vëllimi A, nr. 56, f. 15, § 53; GjEDNj, *Styranowski kundër Polonisë*, aktgjykimi i datës 30 tetor 1998, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1998-VIII, f. 3376, § 46).

24. Paneli më tej vëren se procedura zgjati deri më 15 maj 2008, kur Gjykata Supreme lëshoi aktgjykimin e saj.

25. Rrjedhimisht, procedura ka zgjatur pesë vite e njëzet e tetë ditë, nga të cilat tri vite e njëzet e dy ditë doli të jetë shqyrtuar nga Paneli. Gjatë kësaj periudhe të fundit, lënda është shqyrtuar nga Gjykata e qarkut dhe nga Gjykata Supreme, pasi që është shqyrtuar edhe nga Gjykata komunale. Gjithsej, tri gjykata në instanca të ndryshme kanë shqyrtuar këtë lëndë.

b. Vlerësimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave

26. Lidhur me ndërlikueshmërinë e rastit, në veçanti Paneli tërheq vëmendjen në arsyen, në bazë të së cilës gjykatat relevante hodhën poshtë padinë e paditësit, gjegjësisht vet faktin se i padituri (Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale) nuk ka qenë trashëgimtare ligjore e Entit të punësimit të Republikës së Jugosllavisë. Paneli konsideron se lënda nuk është karakterizuar nga vështirësi të veçanta faktike apo ligjore. Në të kundërtën, mund të thuhet se lënda nuk ka qenë fare e ndërlikuar.

27. Sa i përket sjelljes së ankuesit, nga informatat dosjes së lëndës apo nga parashtresat e PSSP-së nuk duket se ankuesi ka qenë përgjegjës për çfarëdo vonese të procedurës.

28. Sa i përket sjelljes së autoriteteve, Paneli vëren se ka pasur boshllëk të gjatë në procedurat para Gjykatës së qarkut. Rreth dy vite e gjysmë, duke përfshirë edhe rreth një vit e gjysmë pas datës 23 prill 2005 kanë kaluar nga pranimi i dosjes së lëndës në Gjykatën e qarkut dhe marrjes së vendimit të Gjykatës. Nuk duket se ka pasur ndonjë hap tjetër procedural mes fillimit dhe fundit të procedurave të ankesës.

29. Nga shpjegimi i dhënë nga Gjykata e qarkut është e qartë se gjatë kohës në fjalë Gjykata ka pasur vetëm dy gjyqtarë që janë marrë me një numër të madh të lëndëve. Numri i madh i lëndëve ishte arsyeja kryesore pse lënda e ankuesit nuk është trajtuar më shpejtë. Në këtë aspekt, Paneli është në dijeni për vështirësitë, me të cilat është ballafaquar Gjykata e qarkut gjatë punës së saj në një gjendje të pasluftës. Siç është cekur më lartë, në rrethana

të tilla nga autoritetet nuk kërkohen ndonjë përgjegjësi nëse ato ndërmarrin masat e duhura korrigjuese me shpejtësinë e duhur (§ 22). Megjithatë, nuk duket që as Gjykata e qarkut e as UNMIK-u nuk kanë ndërmarrë veprime korrigjuese. Është e qartë se nuk duket se masat e tilla kanë pasur çfarëdo efekti gjatë periudhës relevante.

30. Për më tepër, Paneli konsideron se është e udhës që t'i jepet rëndësi e veçantë se cili ishte interesi i ankuesit. Një i punësuar që konsideron se punëdhënësi e ka pezulluar apo shkarkuar nga puna padrejtësisht ka një interes të rëndësishëm personal për të marrë vendim gjyqësor të shpejtë lidhur me ligjshmërinë e asaj mase, pasi që për nga natyra e tyre, kontestet rreth çështjes së punësimit kërkojnë vendim të shpejtë, duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj për personin në fjalë, i cili përmes shkarkimit nga puna humb mundësinë për ta mbajtur vetën (shih GjEDNj, *Obermeier kundër Austrisë*, aktgjykimi i datës 2 qershor 1990, *Publikimet e gjykatës*, Vëllimi A, nr. 179, f. 23-24, § 72; GjEDNj, *Caleffi kundër Italisë*, aktgjykimi i datës 24 maj 1991, *Publikimet e gjykatës*, Vëllimi A, nr. 206-B, f. 20, § 17; GjEDNj (Dhoma kryesore), *Frydlender kundër Francës*, aktgjykimi i cekur më lartë, § 45). Rëndësia e posaçme e këtyre procedurave për të punësuarit pasqyrohet në legjislaturën përkatëse: përmes nenit 434 të Kodit të procedurës civile të RSF të Jugosllavisë (1982 RSFJ *Ligji për procedurën kontestimore*), i zbatueshëm përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999, gjykatat urdhërohen t'i kushtojnë vëmendje të duhur nevojës së zgjidhjes urgjente të kontesteve të punësimit.

3. Përfundim

31. Duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, Paneli konsideron që Gjykata e qarkut nuk ka treguar gatishmëri, e cila kërkohet nga ajo sipas ligjit vendor në fuqi dhe nenit 6 të KEDNj-së (krahaso GjEDNj, *Cravcenco kundër Moldavisë* nr. 13012/02, aktgjykimi i datës 15 prill 2008, § 57). Paneli përfundon se kohëzgjatja e procedurave për rastin në fjalë ka qenë e madhe dhe ka nuk ka përmbushur kushtin e kohës së arsyeshme.

32. Rrjedhimisht, ka ndodhur shkelja e nenit 6 § 1 të KEDNj-së.

V. REKOMANDIMET

33. Paneli konsideron se shkelja e të drejtës së ankuesit për marrjen e vendimit brenda kohës së arsyeshme në vetvete përbën satisfaksion të mjaftueshëm për çfarëdo dëmi jomonetar të përjetuar nga ankuesi.

34. Si masë e përgjithshme, Paneli rekomandon që UNMIK-u të tërheq vëmendjen e autoriteteve kompetente për këtë Mendim, në mënyrë që ato ta marrin parasysh.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT SA I PËRKET KOHËZGJATJES SË PROCEDURAVE PËR LËNDËN E ANKUESIT;

2. REKOMANDIN QË UNMIK-U T'UA TËRHEQ VËMENDJEN AUTORITETEVE KOMPETENTE PËR KËTË MENDIM.

Rajesh TALWAR Zyrtar ekzekutiv	Marek NOWICKI Kryesues